



SYLLABUS I LËNDËS “SILVIKULTURA 2”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave të Jeta dhe Mjedisit
Titulli i lëndës:	Silvikultura 2
Programi:	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i dytë , semestri i dytë
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Do shpallet
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc.Dr. Mirvjena Kellezi
Të dhënat kontaktuese:	mirvjena.kortoci@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lende do të na njohë me parimet baze të objektit, qëllimit e destinacionit të pyllzimeve. Mundësitë e krijimit të pyllit: bazat e kultivimit të pyjeve artificiale, pyllzime, pyllzime në toka zhveshura, nën masiv, etj.</p> <p>Njohja e mjedisit në objektin e pyllzimeve. Kriteret që ndiqen për njohjen e mjedisit. Zgjedhja e llojeve në pyllzime. Rëndësia dhe kriteret që ndiqen. Grumbullimi i frutave dhe farave pyjore. Koha e arritjes dhe e grumbullimit të farave. Zgjedhja e masiveve dhe e druveve pyjore, plantacionet farore. Teknika e grumbullimit.</p> <p>Njerrja e farave nga boçet dhe frutat. Ruajtja e farave pyjore. Menyrat e ruajtjes së farave. Rregullat e transportit të farave.</p> <p>Treguesit sasior e cilësor të farave pyjore dhe menyrat e përcaktimit të tyre. Përgatitja e farave për mbjellje. Menyrat e përgatitjes.</p> <p>Fidanishtet pyjore. Llojet e fidanishteve pyjore dhe organizimi i tyre. Zgjedhja e vendit të fidanishtes. Radha e vendosjes së kulturave dhe plani tekniko-organizativ i fidanishtes pyjore. Përpunimi dhe mirembajtja e tokës në fidanishte.</p> <p>Prodhimi i fidaneve me fare. Prodhimi vegjetativ i fidaneve pyjore. Vjelja e materialit mbjelles në fidanishte.</p> <p>Teknikat e pyllzimeve artificiale. Siperfaqet e mundshme për pyllzime. Metodët e pyllzimit: pyllzimi me fare, fidane, kalema e shpatulla dhe i perzier.</p> <p>Menyrat e punimit dhe përgatitjes së tokës në pyllzime. Përgatitja dhe përmirësimi i tokës. Masa paraprake për përgatitjen dhe përmirësimin e tokës. Menyrat dhe koha e përgatitjen.</p> <p>Perzierja e llojeve dhe vendosja e kulturave në pyllzime. Skemat dhe formulat e pyllzimeve.</p> <p>Pyllzimet me fare. Menyrat dhe kohet e mbjelljes: me shpërndarje në rreshta, e grupa.</p>

	<p>Pyllezimet me fidane. Materiali mbjelles dhe pergatitja e tij. Koha dhe menytrat e mbjelljes se fidaneve. Thellesia dhe teknika e mbjelljes.</p> <p>Punimet e kujdesimit ne kulturat pyjore pas pyllezimit. Rendesia dhe llojet e kujdesimeve kulturore. Koha e kryerjes se tyre.</p> <p>Matja dhe kontrolli i punes ne pyllezimet e reja. Verifikimi i zenieve dhe studimi i pyllezimeve te reja. Metodrat dhe menytrat e studimit te kulturave pyjore. Vendosja e siperfaqeve prove.</p> <p>Raste te veçanta pyllzimi.</p>		
<p>Qëllimi i lëndës:</p>	<p>Qëllimi i lëndes Silvikultura 2 është njohja e mjedisit dhe zgjedhja e llojeve të pershtateshme në pyllezime artificiale</p> <p>Menytrat e grumbullimit, ruajtjes dhe analizat laboratorike të farave pyjore.</p> <p>Procedurat tekniko-ekonomike të ndertimit dhe funksionimit të fidanishteve pyjore.</p> <p>Menytrat e pergatitjes se farave dhe teknikat e prodhimit të fidaneve në fidanishtet pyjore.</p> <p>Sistemet e punimit dhe pergatitjen e tokes, pleherimin dhe ujitjen në fidanishtet pyjore.</p> <p>Shumezimin gjenerativ dhe vegjetativ të specieve pyjorene fidanishte.</p> <p>Kultivimin e specieve pyjore në sera dhe me rrenje të mbuluara (konteinera). Menytrat dhe koha e pergatitjes se tokes në objektet e pyllezimeve artificiale. Menytrat e perzierjes dhe vendosjes se llojeve pyjore në objektet e pyllezimit (formulat dhe skemat).</p> <p>Menytrat dhe teknikat e pyllezimet artificiale me fare dhe fidane. Mekanizmat e punes.</p> <p>Menytrat e vleresimit të punes në kulturat e pyllezimeve dhe studimi i tyre.</p>		
<p>Rezultatet e të nxënit:</p>	<p>Pas perfundimit të kesaj lende studenti duhet të jene në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikojne qëllimin dhe destinacionin e pyllezimeve. 2. Zgjedhe llojet e pershtatshme për pyllezime. 3. Klasifikojte frutat dhe farat pyjore të pershtatshme për grumbullim. 4. Perdore menytrat e duhura për ruajtjen e farave pyjore. 5. Dizajnoje dhe menaxhoje fidanishtet pyjore. 6. Vleresoje prodhimin e fidaneve në mjedise të mbyllura (sera diellore dhe me ngrohje artificiale). 7. Krahasojte teknikat e pyllezimeve artificiale dhe të vendose siperfaqet e mundeshme për pyllezime. 		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej



Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	1	15	15
Kollokfiume, seminare	2	-	2
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	5	10
Projektet, prezantimet ,etj	3	-	3
Totali			150 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, seminare, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, detyre kursi, provime.		
Metodologjia e vlerësimit:	Vlerësimi i parë (kolokvium): 10%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 10%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Provimi final: 70%, Total: 100%.		
Literatura			
Literatura primare:	Tabaku, V. (2015): Silvicultura speciale. Leksione te shkruara per studentet. Treska .LL. Pyllzimet. Kortoçi, Y., Kellezi, M. (2012): Shfrytëzimi i pyjeve te ahut te Shqiperise me nje silvikulture te qendrushme. Kellezi, M., Kortoci, Y. (2013): “L’impiego delle coltivazioni arboree a rapida crescita per produrre energia verde:metodi culturali raccolta e impieghi”.		
Literatura shitesë:	Tabaku, V. (2015): Silvicultura Speciale. Leksione te shkruara per studentet. Marku, V.(2014): Dendrologjia Grazhdani, S. (2003): Agrometeorologjia. Botim i UBT.		

Plani i dizajnuar i mësim:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Objekti, qellimi e destinacioni i pyllzimeve.	Praktike ne lidhje me njohjen e mjedisit te pyllzimeve dhe

	<p>Riprodhimi i bimeve. Mundesite e krijimit te pyllit: bazat e kultivimit te pyjeve artificiale, pyllzime, pyllzime ne toka zhveshura, nen masiv, etj.</p> <p>Njohja e mjedisit ne objektin e pyllzimeve. Kriteret qe ndiqen per njohjen e mjedisit ne pyllzime. Studimi i klimes, rrezatimit diellor, dukurite e thatesires, studimi i tokes per vendosjen e llojeve, etj.</p>	<p>zgjedhjen e llojeve per objekte me kushte te ndryshme ekologjike.</p>
<p><i>Java e dytë:</i></p>	<p>Zgjedhja e llojeve per ne pyllzime. Rendesia dhe kriteret qe ndiqen. Veprimet qe kryhen per vendosjen e llojeve dhe zgjedhjen e tyre. Llojet e vendit, te huaja dhe pergatitore. Metoda e ekologjise se krahasuar, e studimit te tipologjise pyjore dhe e eksperimentimit Grumbullimi i frutave dhe farave pyjore. Arrirja dhe pjekja e frutave dhe farave pyjore. Klasifikimi, koha e arrirjes dhe e grumbullimit te farave. Zgjedhja e masiveve dhe e drureve pyjore, plantacionet farore. Menyra dhe teknika e grumbullimit te farave.</p>	<p>Praktike mbi menytrat e grumbullimit te farave pyjore dhe parashikimin e prodhimit te farave nga druret e grumbujt pyjore.</p>
<p><i>Java e tretë:</i></p>	<p>Nxjerrja e farave nga boçet dhe frutat. Nxjerrja e farave te pishave me nxehtesi artificiale (boçethareset) ose me nxehtesi natyrale. Nxjerrja e farave nga lloje halore qe kerkojne trajtim te veçante.</p> <p>Pergatitja e kampioneve per analizat laboratorike mbi treguesit sasiore dhe cilesor te farave.</p>	<p>Praktike mbi metodat e percaktimit ne laborator te treguesve sasiore dhe cilesore te farave pyjore.</p>

<p><i>Java e katërt:</i></p>	<p>Ruajtja e farave pyjore. Menyrat e ruajtjes se farave: ruajtja ne mjedis te thate, te zakonshem, te rregulluar dhe ne ene hermetike. Ruajtja e farave ne mjedis te laget. Rregullat e transportit te farave pyjore. Treguesit sasior e cilesor te farave pyjore dhe menyrat e percaktimit te tyre. Menyrat e percaktimit te aftesise mbirese te farave pyjore: me kultivim ne laborator, me metoden biokimike dhe rentgenografike.</p>	<p>Praktike ne fidanishte pyjore mbi menyrat e trajtimin paraprak te farave pyjore para mbjelljes se tyre ne farishtore.</p>
<p><i>Java e pestë:</i></p>	<p>Pergatitja e farave per mbjellje (Bazat teorike). Menyrat e pergatitjes: shtratifikimi, shtratifikimi ne te ftohte, trajtimi hidrotermik e kimik, perpunimi i farave me mikroelemente, dezinfektimi e parambirja). Fidanishtet pyjore. Llojet e fidanishteve pyjore dhe organizimi i tyre. Zgjedhja e vendit te fidanishtes. Radha e vendosjes se kulturave dhe plani tekniko-organizativ i fidanishtes pyjore.</p>	<p>Praktike mbi problemet ndertimore, perdorimi i makinave dhe i mjeteve te tjera ne fidanishtet pyjore.</p>
<p><i>Java e gjashtë:</i></p>	<p>Perpunimi dhe mirembajtja e tokes ne fidanishte. Sistemet e punimit te tokes ne fidanishte, perdorimi i herbicideve, pleherimi, llojet e plehrave. Pergatitja e tokes per mbjelljen ne fidanishte. Prodhimi i fidaneve me fare. Farishtorja: Menyrat e mbjelljes se fares. Thellesia dhe koha e mbjelljes se fares ne farishtore. Mbjelljet me krahe dhe me makine.</p>	<p>Praktike per problemet e punimit te tokes, pergatitja e vullajave, pleherimi dhe tekniken e ujitjes se kulturave ne fidanishtet pyjore.</p>

	Punimet e kujdesimit ne farishtore.	
<i>Java e shtatë:</i>	<p>Prodhimi i fidaneve ne mjedise te mbyllura (sera diellore dhe sera me ngrohje artificiale. Prodhimi i fidaneve me rrenje te mbuluara me buke dhe ne qeska plastmasi, vazo torfe, vazo kartoni, konteineri. Shperngulja e fidaneve ne fidanishte. Qellimi dhe menytrat e shper-nguljes se fidaneve. Sherbimet e kujdesimit ne shperngultore.</p>	Praktike ne fidanishte mbi shumezimin gjenerativ dhe vegjetativ te specieve pyjore (In-vitro, me shartim, me perpajna, etj).
<i>Java e tetë:</i>	<p>Prodhimi vegjetativ i fidaneve pyjore. Shumezimi vegjetativ me kalema 2-vjeçare, kalema te gjelbert, kalema rrenjore, me thithake, me perpajna dhe shumezimi me shartim.</p> <p>Vjelja e materialit mbjelles ne fidanishte (Llogaritja e materialit mbjelles: inventarizimi i fidaneve ne farishtore dhe shperngultore.</p>	Seminari 1: Kapitujt mbi farat pyjore, treguesit sasior dhe cilesor te tyre dhe prodhimi i fidaneve pyjore ne fidanishtet pyjore.
<i>Java e nëntë:</i>	<p>Teknikat e pyllzimeve artificiale. Siperfaqet e mundeshme per pyllzime. Metodat e pyllzimit: pyllzimi me fare, fidane, kalema e shpatulla dhe i perzier. Menytrat e punimit dhe pergatitjes se tokes ne pyllzime. Pergatitja e tokes dhe permiresimi i saj. Qellimi dhe rendesia e pergatitjes. Masa paraprake per pergatitjen dhe permiresimin e tokes. Menytrat dhe koha e pershtatshme per pergatitjen e tokes ne pyllzime.</p>	Praktike ne fidanishte mbi kultivimin e llojeve pyjore ne fushe te hapur (mbjellja ne farishtore, shperngulja e fidaneve, luftimi i barerave te keqija me herbicide.

<p><i>Java e dhjetë:</i></p>	<p>Perzierja e llojeve dhe vendosja e kulturave ne pyllezime. Skemat dhe formulat e pyllezimeve. Vendosja e kulturave ne menyre te �rregullt dhe te rregullt. Dendesia e kulturave ne pyllezime. Pyllezimet me fare. Menyrat dhe kohet e mbjelljes: me shperndarje ne rreshta, e gropa. Thellesia e mbulimit dhe normat e fares.</p>	<p>Praktike mbi punimet ne sere per punimin e tokes, teknikat e ujitjes dhe kultivimin e specieve pyjore ne vazo e konteinera te ndryshme.</p>
<p><i>Java e nj�mb�dhjet�:</i></p>	<p>Pyllezimet me fidane. Materiali mbjelles dhe pergatitja e tij. Koha dhe menyrat e mbjelljes se fidaneve: me krahe ose mjete te mekani-zuara. Thellesia dhe teknika e mbjelljes. Punimet e kujdesimit ne kulturat pyjore pas pyllezimit. Rendesia dhe llojet e kujdesimeve kulturore. Koha e kryerjes se tyre.</p>	<p>Praktike ne fidanishte mbi menyrat e shkuljes, asortimit dhe ambalazhimit te materialit mbjelles ne fidanishte.</p>
<p><i>Java e dymb�dhjet�:</i></p>	<p>Matja dhe kontrolli i punes ne pyllezimet e reja. Verifikimi i zenieve dhe studimi i pyllezimeve te reja. Metodot dhe menyrat e studimit te kulturave pyjore. Vendosja e siperfaqeve prove. Raste te veçanta pyllzimi. Brezat mbrojtjes pyjore. Klasifikimi i bre-zave mbrojtjes: sipas materialit, funksionit, dendesise e struktures. Llojet qe perdoren, teknika e kultivimit dhe sherbimet e kujdesimit.</p>	<p>Praktike mbi pyllezimet artificiale direkt me fare (punimet paraprake ne objektin qe do te pyllezohet, trajtimi paraprak dhe shtratifikimi i fares. Format dhe teknikat e mbjelljes me fare).</p>
<p><i>Java e tremb�dhjet�:</i></p>	<p>Pyllezimet ne pellgjet ujembledhes dhe i tokave rreshqitese. Pyllezimi i ranishteve bregdetare dhe zallishteve te</p>	<p>Praktike ne nje siperfaqe pyllezimi mbi menyrat e pyllezimit me fidane (pyllezimi me shate special, me bel, me gropa.</p>

	lumenjeve. Zgjedhja dhe vendosja kulturave. Mbjellja dhe kujdesimet kulturore.	
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Pyllezimet ne kullota malore. Teknika e mbjelljes dhe shërbimet e kujdesimit pas mbjelljes. Pyllezimi gjate rrugëve automobilistike dhe ne zonat e gjelberta te qyteteve.gjedhja e llojeve dhe teknikat e pyllezimit. Shërbimet.	Njohje me makinat qe perdoren ne fidanishte dhe per pyllezimin me fidane ne objektet e pyllezimit.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kultivimi i llojeve pyjore halore te vendit (bredhi i bardhe, hormoqi, arneni, hartina, pisha eger, e bute, pisha e zeze, rrobulli, selvia, etj.). Kultivimi i llojeve pyjore fletore te vendit (ahu, arra e bute, bliri fleteserme, bunga, bungebuta, qarri, plepat, shparthi, geshtenja. Kultivimi i llojeve te huaja (bredhi i greqise, cedri i atlasit, cedri i himalajes, cedri i libanit, selvia e lavsonit, libocedri, selvia e arizones, pisha e detit, pisha e verdhe, pisha e montereit ose rrezore, pisha e bardhe, bredhi i gjelbert, arra e hindit, eucalyptet, hipofaja, vidhi kanadez dushku kuq, robinia, plepat.	Seminar 2: Fidanishtet pyjore dhe pyllezimit artificiale.
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjese ne vizita studimore ne terren(ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësim po ashtu janë obligative.		